



Në bazë të dispozitave të nenit 20 të Ligjit nr. 04/L – 111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike 03/L – 087, të dispozitave të neneve 2, paragrafi 2.2 dhe 13, paragrafi 13.1 të Ligjit nr. 2003/19 për sigurinë në punë, shëndetit dhe mjedisin e punës, të nenit 9 të Ligjit nr. 04/L - 012 mbi mbrojtjen nga zjarri, Bordi i drejtoreve i NPL “Stacioni i autobusëve”SH. A., Prishtinë më 25.01.2015, miraton këtë

**RR E G U LL O R E  
PËR  
MBROJTJE NGA ZJARRI**

**I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1.**

**1. Qëllimi**

Në pajtim me dispozitat ligjore, ndërmarrja më qëllim të mbrojtjës së të punësuarëve dhe të pasurisë së saj nga zjarri si dhe pengimit, parandalimit dhe evitimit të rrezikut nga pasojat që mund të shkaktoj zjarri përcakton:

Masat e mbrojtjës nga zjarri,  
Organizimin e mbrojtjës nga zjarri,  
Të drejtat dhe obligimet e të punësuarve lidhur me zbatimin e masave parandaluese për mbrojtje nga zjarri,  
Përgjegjësin e tyre në rast të mosrespektimit të masave parandaluese dhe detyrat në rast të shpërthimit të zjarrit si dhe pjesëmarrien në shuarjën e tij.  
Mënyrën e trajnimit, pajisjet teknike dhe mjetet për shuarjën e zjarrit si dhe ndërmarrjën e veprimeve adekuate për shuarjën e tij në rast shpërthimi.

**Neni 2.**

Mbrojtja nga zjarri përfshinë tërësinë e masave dhe ndërmarrjën e veprimeve konformë akteve normative të ndërmarrjes më qëllim të parandalimit, pengimit, zgjerimit si dhe shuarjës së zjarrit nëse eventualisht shpërthen në objektet e ndërmarrjes.

### Neni 3.

Mbrojtja nga zjarri organizohet dhe zbatohet në çdo kohë në të gjitha objektet e ndërmarrjes dhe lokalet të cilat i ka në shfrytëzim, në harmoni me aktet normative në fuqi, planit për reagim emërgjent si dhe të dispozitave të kësaj Rregulloreje.

### Neni 4.

## 2. Përkufizimet

Termet e përdorura në këtë Rregullore përkufizohen si vijon:

**“Rregullore”**, Akt i karakterit të përgjithshme më cilin më afersisht përpunohen rregullat të caktuara të ligjit ose të dispozitës për zbatimin e saj.

**“Zjarri”**, është reaksion kimik i tri burimeve: lëndës djegëse, nxehësisë dhe oksigjenit.

**“Mbrojtja nga zjarri”** nënkupton shpëtimin e njerëzve, të pasurisë dhe të mjedisit të rezikuar nga zjarri dhe shpërthimet, ofrimin e ndihmës teknike në fatkeqësi dhe në situata të rezikshme, zbatimin e masave parandaluese dhe kryerjen e detyrave të tjera të përcaktuara me planin e mbrojtjes nga zjarri.

**“Parandalimi”** nënkupton tërësinë e masave dhe punëve, të cilat ndërmerrën në parandalimin e shkaktimit të zjarrit apo për zvogëlimin e pasojave të zjarrit.

**“Prona”** nënkupton objektet, pjesët e objekteve dhe hapësirat, të cilat janë në pronësi të kolegjit.

**“Reagimi emergjent”**, nënkupton veprimet e kryera në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera nga autoritetet qendrore, komunale dhe nga shërbimet emergjente për zvogëlimin dhe lehtësimin e dëmeve të shkaktuara në njerëz, pronë ose në mjedis.

**“Shërbimet emergjente”**, nënkuptonjë shërbimet e siguruara nga: FSK, Policia e Kosovës, shërbimet emergjente mjekësore spitalore dhe para spitalore të Kosovës, shërbimet komunale të zjarrfikës dhe të shpëtimit dhe shërbimet emergjente mjekësore komunale dhe OJQ-të përkatëse.

### Neni 5.

## Masat e mbrojtjës nga zjarri

Me qëllim të evitimit të shkaqëve të shpërthimit, të pengimit, të zgjerimit dhe shuarjës së zjarrit, shpëtimit të punësuarëve dhe pasurisë së rezikuar nga zjarri në objektet e ndërmarrjes dhe lokalet ku ajo vepron duhet të ndërmirren masat adekuate për mbrojtje nga zjarri siç janë:

- a) aplikimi i normave teknike në të gjitha objektet e ndërmarrjes sipas standardeve për mbrojtje nga zjarri apo adoptimi i tyre dhe rikonstruimi i objekteve ekzistuese me instalimin e pajisjeve adekuate;
- b) pajisja e objekteve me hidrante si dhe pajisje me mjete tjera për shuarjën e zjarrit të cilat janë paraparë më ligj;
- c) vendosja e tyre në objekte precizohet me Planin për reagim emërgjent në ndërtesën ku vepron.
- d) instalimet dhe pajisjet elektrike, të ventilimit, të ngrohjes, rrufepritësit, kanalizimi etj në objektet e kolegit mund të vendosen në ato vende në mënyrë profesionale me qëllim që të mos paraqesin rrezik nga zjarri. Personat e autorizuar janë të obliguar që të bëjnë kontrollin e gjendjes dhe të funksionimit të drejtë të të gjitha pajisjeve dhe instalimeve më qëllim që të mos janë shkaktare të zjarrit nëse eventualisht mund të dëmtohen;
- e) në objektet e ndërmarrjes ndalohet përdorimi i zjarrit të hapur, llambave ndriçuese me gaz, mjeteve tjera ndezëse me shkrepje, shfrytëzimi i aparateve ngrohëse me sipërfaqe të skuqur-ndezur, mbajtja dhe vendosja e materialeve që lehtë ndezën. Me vendim të posaçëm caktohen vendet ku mund të pihet duhani, ndërsa në lokalet tjera është e ndaluar pirja e duhanit;
- f) është obligim për të gjithë të punësuarit në ndërmarrje që të bëjnë ç'kyçjen e të gjitha aparateve termoelektrike dhe pajisjeve tjera pas mbarimit të orarit të punës;
- g) hyrjet - daljet, kalimet dhe shkallët në objektet e ndërmarrjes duhet të janë gjithmonë të lira për kalim;
- h) në objektet e m ndërmarrjes ndalohet kryerja e veprimeve - punëve që mund të janë nxitës të zjarrit, ato mund të kryhen me leje të veçantë të Kryeshefit, pasi që më parë të janë marrë të gjitha masat për mbrojtje nga zjarri.

#### **Neni 6.**

Aparatet, pajisjet dhe mjetet e dedikuara për shuarjën e zjarrit si dhe pajisjet dhe instalimet për lajmërim dhe sinjalizim automatik të zjarrit në objektet e ndërmarrjes mund të përdorën vetëm atëherë kur t'i përbushin kriteret e parapara me ligj dhe standardet e parapara teknike ose pas marrjës së atestit nga institucioni i autorizuar.

- a) aparatet, pajisjet dhe mjetet për shuarjën e zjarrit vendosen në vende të përshtatshme ku çasja është e lirë në objektin e ndërmarrjes ato mund të përdorën dhe shfrytëzohen vetëm për shuarjën dhe lokalizimin e zjarrit;
- b) vendet në të cilat ndodhën mjetet për shuarjën e zjarrit shënohen me shenja dalluese;
- c) aparatet, pajisjet dhe mjetet për shuarjën e zjarrit si dhe pajisjet për sinjalizimin e lajmërimit automatik të zjarrit mbahen në gjendje të rregullt dhe për to mbahet evidencë;
- d) Përgjegjës për vendosjen, mirëmbajtjen, rimbushjen dhe kontrollimin teknik të aparateve është përgjegjësi për siguri në ndërmarrje.

#### **Neni 7.**

#### **4. Organizimi i mbrojtjës nga zjarri**

Me qëllim të zbatimit të masave të parapara për mbrojtje nga zjarri si dhe të aktiviteteve dhe detyrave tjera të parapara me Ligjin për mbrojtje nga zjarri dhe me

aktet tjera që e rregullojnë këtë lëmi përcaktohet organizimi i mbrojtjës nga zjarri në objektet e ndërmarrjes.

### **Neni 8.**

Aktivitetet e zbatimit të masave parandaluese të mbrojtjës nga zjarri dhe fatkeqësive tjera në kolegj i kryen zyrtari i sigurimit në bashkpunim më personelin e ndërmarrjes i cili është i obliguar të plotësoj kriteret themelore për krijimin e marrëdhënies së punës siç janë: përgatitjet adekuate shkolllore e cila përcaktohet me aktin mbi sistematizimin e vendeve të punës në kolegj, kryerjen e trajnimeve teorike dhe praktike nga kjo lëmi në institucionet shtetërore apo ato të cilat janë të licencuara nga organet kompetente.

### **Neni 9.**

Punëtorët të cilët kryejnë detyrat e sigurimit janë të obliguar që:

- a) gjatë orarit të punës në shërbim veç tjerash të kryejnë edhe punët e drejtpërdrejta të mbrojtjës nga zjarri në bazë të Ligjit, kësaj Rregulloreje, akteve tjera normative të kolegit ;
- b) gjatë kujdestarisë viziton objektin, të gjitha hapësirat, aparatet për fikje të zjarrit, pajisjet tjera dhe instalimet e nëse vëren parregullsi lajmëron udhëheqësin e drejtpërdrejtë dhe njëkohësisht ndërmerr masa për pengimin e pasojave të padëshirueshme;
- c) të njoftohet me masat e mbrojtjës nga zjarri të përcaktuara me këtë Rregullore dhe të parapara me Planin për reagim emërgjent, të studion ato vazhdimeshit me qëllim të zbatimit më me efikasitet në rast se ndodh ndonjë fatkeqësi;
- d) të aftësohet nga fushëveprimi i mbrojtjës nga zjarri duke marr pjesë në trajnime të cilat i organizon organi kompetent në institucionet profesionale nga kjo lëmi;
- e) me rastin e pranimit të detyrës punëtori është i obliguar të jetë i aftë në aspektin psiko - fizikë për kryerjen e obligimeve gjatë orarit të punës;
- f) obligohet që t'i ruaj, mirëmbajë dhe shfrytëzoj pajisjet personale dhe të përbashkëta me të cilat është ngarkuar gjatë orarit të punës dhe të zbatojë kodin e mirësjelljës;
- g) është i obliguar që gjatë orarit të punës të ndërmerr të gjitha masat për mbrojtjen e objektit, të punësuarëve dhe pasurisë së ndërmarrjes nga fatkeqësitë e ndryshme eventuale.

### **Neni 10.**

Koordinatori për sigurim ndërmerr të gjitha masat e domosdoshme parandaluese nga zjarri më qëllim të ruajtjës së punëtorëve, dhe pasurisë së siç janë:

- a) organizimi dhe zbatimi i mbrojtjës nga zjarri më qëllim të ngritisë të shkallës së sigurisë;
- b) kujdeset për zbatimin dhe aplikimin e masave preventive për mbrojtje nga zjarri në bazë të Planit të reagimit emërgjent nëobjektin ku e zhvillon veprimtarin e vetë kolegji si dhe më këtë Rregullore;
- c) merrë pjesë në trajnime dhe informohet për rreziqet që mund të shkaktoj zjarri, aftësohet për përdorimin dhe karakteristikat e aparateve dhe pajisjeve tjera për shuarjën e zjarrit;
- d) kontrollon gjendjën dhe funksionalitetin e pajisjeve për shuarjën e zjarrit dhe mbanë evidencë të rregullt për to;
- e) kontrollon se a janë të vendosura në vendet e parapara shenjat e domosdoshme që tërheqin vërejtjen për rrezikun e mundshëm;
- f) udhëzimet për përdorimin e aparateve përkatëse, shenjat që tregojnë drejtimin e daljës nga rreziku prej zjarrit apo fatkeqësive tjera;
- g) bënë zëvendësimin dhe tërheqjën e aparateve të vjetruara dhe të pa përdorshme dhe bën vendosjen e aparateve funksionale;

- h) bashkëpunon me ekipin për mbrojtje nga zjarri me njësitin komunal të zjarrfikësve për të gjitha çështjet nga kjo lëmi me qëllim të shqyrtimit të problemeve dhe zgjedhjës adekuatë të tyre;
- i) bënë vizita ditore dhe gjatë natës me qëllim të mbikëqyrjes së aplikimit të masave propozon masa ndëshkuese ndaj të gjithë atyre që nuk i përmbahen Rregullorës;
- j) bënë kontrollimin e rregullimit, pastrimit dhe mirëmbajtjës së lokaleve të punës veçmas lidhur më zënjen e hyrje – daljeve, qasjen e hidrantëve, aparateve dhe mjeteve tjera ndihmëse për shuarjën e zjarrit;
- k) në rast rreziku të drejtpërdrejtë nga shpërthimi i zjarrit apo ndonjë fatkeqësie tjetër, ndërmerr masa të menjëherë përvetësimi e tyre dhe ndalon punën në vendet e rrezikuara, për çka menjëherë lajmëron bashkëpunëtorin profesional për mbrojtje në punë apo udhëheqësin tjetër kompetent në objektin ku ndodhë fatkeqësia;
- l) informon me shkrim koordinatorin për Burime Njerëzore dhe Organizim për parregullsitë e përcaktuara të mbrojtjës kundër zjarrit me qëllim të evitimit të tyre;
- m) harton informata për gjendjën e mbrojtjës nga zjarri në objektet e kolegjit dhe propozon masa përvetësimi e mangësive dhe të parregullsive;
- n) kryen edhe punë tjera të parapara me aktet normative të ndërmarrjes.

### **Neni 11.**

Personi i autorizuar organizon dhe orienton punën e shërbimit dhe bashkëpunon që të:

- a) kujdeset për zbatimin e masave të mbrojtjës nga zjarri të parapara me Ligj dhe aktet tjera normative si dhe zbatimin e kësaj Rregulloreje në ndërmarrje;
- b) përcjell dhe studion dispozitat ligjore nga lëmi i mbrojtjës kundër zjarrit dhe ndërmerr masa të duhura për të harmonizuar punën e shërbimit me ato dispozita me qëllim të avancimit të mbrojtjës kundër zjarrit;
- c) mbikëqyrë gjendjën e mbrojtjës kundër zjarrit dhe të sigurisë së objekteve, personelit dhe pasurisë në kolegj dhe ndërmerr masa përvetësimi e tyre dhe pengimin e pasojave të dëmshme;
- d) merr pjesë në përgatitjen e propozimeve të planeve në lëmin e mbrojtjës nga zjarri dhe pas aprovimit të tyre kujdeset përvetësimi e tyre;
- e) bashkëpunon me organet kompetente komunale dhe subjektet tjera nga kjo lëmi.

### **Neni 12.**

Kryeshefi ekzekutiv në lëmin e organizimit, zbatimit dhe avancimit të mbrojtjës nga zjarri veç detyrave që kanë kompetencë të precizuara me aktet normative të ndërmarrjes është i obliguar që të kryej edhe këto detyra:

- a) të zbatojë më konsekuençë Rregullorën për mbrojtje nga zjarri të aprovuar nga Bordi i drejtoreve i ndërmarrjes;
- b) të zbatojë planin për trajnim për punëtorët e sigurimit në lëmin i mbrojtjës nga zjarri;
- c) të kujdeset përvetësimi e pajisjeve të nevojshme për mbrojtje kundër zjarri dhe ndërmerr masa përvetësimi e teknikëve, kontrollim teknik dhe masa tjera me qëllim të shtimit të shkallës së sigurisë në objektin e kolegjit;
- d) do të mbikëqyrë dëshirat përgjegjës përvetësimi e mbrojtjës kundër zjarrit në objektin e ndërmarrjes,

- e) në rastet kur konstatohen të metat apo mangësitë është i obliguar që menjëherë të ndërmerr masa me qëllim të evitimit të parregullsive të vërejtura;
- f) është i obliguar që me kohë të informojë punëtorët me obligimet e tyre, me gjendjen, masat dhe mjetet që janë në dispozicion me qëllim të zbatimit dhe avancimit të mbrojtjës nga zjarri.

### Neni 13

#### **5. Të drejtat dhe obligimet e BD-ve, dhe të punësuarve lidhur me zbatimin e masave parandaluese për mbrojtje nga zjarri**

Bordi i drejtoreve përveç që aprovon Rregullorën për mbrojtje nga zjarri ka edhe këto detyra:

- a) është i obliguar të krijon kushte për siguri në punë të punësuarve dhe studenteve në kolegji për mbrojtje nga zjarri dhe faktorët që mund të shkaktojnë shpërthimin e zjarrit;
- b) është i obliguar që të krijoj një fond për mbulimin e të gjitha shpenzimeve të domosdoshme për sigurimin e të gjitha pajisjeve mjeteve të mbrojtjës nga zjarri në harmoni me nenin 2, paragrafi 2.2 të Ligjit për siguri në punë, mbrojtje të shëndeti të punësuarëve dhe ambientit të punës.

### Neni 14.

Kryeshefi ekzekutiv në fushën e mbrojtjës nga zjarri ka këto detyra:

- a) realizon dhe mbikëqyr gjendjën e organizimit të mbrojtjës nga zjarri dhe shkallën e sigurisë dhe në bazë të mjeteve që ka në dispozicion, lejon shfrytëzimin e tyre;
- b) aprovon Planin për reagim emërgjent në ndërmarrje;
- c) përcakton përgjegjësinë e bashkëpunëtorëve gjegjësisht zyrtarëve të lartë të ndërmarrjes, në rast të mos përbajtjes së masave të parapara me Rregullore si dhe akteve tjera normative të ndërmarrjes;
- d) shqyrton raportet dhe vendimet e organeve kompetente shtetërore, propozon masa dhe aktivitete që dobësítë e vërejtura të evitohen me kohë;
- e) informon Bordin e drejtoreve të ndërmarrjes për të gjitha çështjet aktuale nga lëmi i mbrojtjes nga zjarri dhe fatkeqësítë tjera.

### Neni 15.

Përgjegjësi në fushën e mbrojtjes nga zjarri ka këto detyrime për organizim të mbrojtjes nga zjarri:

- a) është përgjegjës për organizimin e procesit të punës, të kontrollojnë dhe sigurojnë aplikimin dhe përbajtjen e masave të parapara për mbrojtje nga zjarri dhe fatkeqësive tjera në ndërmarrje për njësinë organizative në të cilën udhëheq dhe në rast se vëren të meta, ndërmarrin masa urgjente për evitimin e tyre;
- b) të iniciojnë procedurat disiplinore për të gjithë të punësuarit nëse nuk u përbahen masave të mbrojtjes nga zjarri.

## **Neni 16.**

Me qëllim të realizimit më efikas të detyrave për mbrojtje të punësuarve, dhe pasurisë së ndërmarrjes nga zjarri dhe fatkeqësitë tjera, Kryeshefi ekzekutiv cakton personin për zjarrëfikje dhe shpëtim i cili është përgjegjës për përcjelljen e gjendjes së organizimit të mbrojtjës nga zjarri dhe zbatimin e masave të parapara me këtë Rregullore.

## **Neni 17.**

### **6. Përgjegjësitë e punëtorëve që nuk i respektojnë masat parandaluese**

Të punësuarit në ndërmarrje janë të obliguar që gjatë orarit të punës t'u përbahen masave të parapara për mbrojtje nga zjarri të përcaktuara me këtë Rregullore, Ligjit për mbrojtje nga zjarri dhe akteve tjera normative.

## **Neni 18.**

Moszbatimi i masave nga neni 15 i kësaj Rregulloreje paraqet shkelje të rëndë të detyrave dhe disiplinës në punë në bazë të Rregullorës mbi përgjegjësinë disiplinore të ndërmarrjes.

## **Neni 19.**

Dispozitat e kësaj Rregulloreje janë të obligueshme dhe aplikohen për të gjithë të punësuarit në ndërmarrje si dhe të gjithë të tjerve të cilët në çfarëdo bazë punojnë ose kryejnë punë në ndërmarrje.

## **Neni 20.**

### **7. Mënyra e trajnimit, pajisjet teknike dhe mjetet për shuarjën e zjarrit si dhe ndërmarrjën e veprimeve adekuate për shuarjën e tij**

Trajnimi i punëtorëve të sigurimit në ndërmarrje në lëmin e mbrojtjës nga zjarri bëhet ekskuluzivisht në institucionet shtetërore apo institucionet e licencuara nga organet kompetente shtetërore në bazë të programit të punës i cili aprovohet nga Kryeshefi ekzekutiv apo nga personi i autorizuar nga ai. Me program parashihet trajnimi për fitimin e njohurive më elementare teorike si dhe praktike, përmes ligjératave, seminareve dhe konsultimeve. Koordinatori për burime njerëzore me plan të posaçëm cakton format dhe mënyrat e trajnimit të punëtorëve të sigurimit varësisht nga mundësítë organizative të realizimit të tyre.

## **Neni 21.**

Për kryerjen me sukses të punëve për mbrojtje të punësuarve, punëtorëve dhe pasurisë në ndërmarrje nga zjarri dhe shuarjën e tij në bazë të dispozitave ligjore për kategorizimin sipas rrezikshmërisë nga zjarri parashihet sigurimi i pajisjeve dhe mjeteve tjera teknike. Për llojet, sasinë dhe tipin e pajisjeve teknike për mbrojtje nga zjarri bëhet plani konkret për secilin objekt të ndërmarrjes.

## Neni 22.

Procedurat në rast të shpërthimit të zjarrit dhe detyrat e të punësuarëve caktohen me Planin për reagim emërgjent të ndërmarrjes.

## II. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

### Neni 23.

Për të gjitha çështjet nga lëmi i mbrojtjës nga zjarri të cilat nuk janë cekur në këtë Rregullore, do të aplikohen dispozitat e Ligjit për mbrojtje nga zjarri dhe aktet tjera që e rregullojnë këtë lëmi.

### Neni 24.

Me përbajtjen e kësaj Rregulloreje të njoftohen të gjithë të punësuarit në ndërmarrje.

### Neni 25.

Kjo Rregullore hynë në fuqi ditën e aprovimit dhe fillon të aplikohen 8 ditë prej ditës së aprovimit nga ana e Bordit të drejtoreve.

Kryesuesi i Bordit të drejtoreve

Naim Neziri



 <b>NDERMARRJA PUBLIKE LOKALE STACIONI I AUTOBUSAVE SH.A.</b> JAVNO LOKALNO PREDUZEĆE AUTOBUŠKA STANICA D.D. PUBLIC ENTERPRISE LOCAL BUS STATION J.S.C.
<b>Nr. 02/65-6</b> <b>Data 25.01.2015</b> No.                  Date <b>PRISHTINË/A</b>

Në pajtim me dispozitat e nenit 20 të Ligjit nr. 04/L – 111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike 03/L – 087 (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 13/2012) dhe pas konsultimeve me zyrtarët e NP , Bordi i drejtorëve i NPL Stacioni i autobusëve, SH. A., Prishtinë, më 25.01.2015, merr ketë:

## V E N D I M

### I. MIRATOI Rregulloret e ndërmarrjes:

1. Rregulloren mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, me përshkrimin e punës dhe detyrave të punës.
2. Rregulloren mbi përgjegjësinë disiplinore dhe materiale të punëtorit në ndërmarrje.
3. Rregulloren për marrëdhënie pune.
4. Rregulloren për mbrojtjen në punë.
5. Rregulloren për mbrojtjen nga zjarri.
6. Rregulloren për punën e BD-ve.
7. Udhëzimin për përdorimin e automjeteve zyrtare.
8. Planin për veprim dhe evakuim.

## A r s y e t i m

Me qëllim të krijimit të infrastrukturës juridike dhe në pajtim me dispozitat e nenit 20 të Ligjit nr. 04/L – 111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike 03/L – 087 (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 13/2012), Bordi i drejtorëve në mbledhjen e mbajtur më 26.01.2015 shqyrtoi projektet e rregulloreve të përgatitura nga menaxhmenti i ndërmarrjes:

Rregulloren mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, me përshkrimin e punës dhe detyrave të punës.  
 Rregulloren mbi përgjegjësinë disiplinore dhe materiale të punëtorit në ndërmarrje.  
 Rregulloren për marrëdhënie pune.  
 Rregulloren për mbrojtjen në punë.  
 Rregulloren për mbrojtjen nga zjarri.

Rregulloren për punën e BD-ve.

Udhëzimin për përdorimin e automjeteve zyrtare.

Planin për veprim dhe evakuim.

Pas vlerësimit dhe shqyrimit të detajuar të secilës rregullore veç e veç lidhur me përputhshmërinë e tyre me dispozitat pozitive përkatëse ligjore të Republikës së Kosovës, BD-ve miratoi rregulloret e ndërmarrjes të cekura më lart.

II. Këto Rregullore hyn në fuqi 8 ditë pas miratimit nga Bordi i drejtoreve.

Me sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryesuesi i Bordit të drejtoreve

Naim Neziri